

+

RAPORT

I VEPRIMTARISE TE DREJTORISE AUDITIMIT TE BRENDSTEM TE ASHK-se PER VITIN 2020

Në zbatim të programit vjetor të Auditimit të Brëndshëm për vitin 2020, te ndryshuar, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr.3856 datë 08.10.2019 “ Për miratimin e Programit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020”, të ndryshuar, Ligjit nr.114 date: 22.10.2015 “ Per auditimin e brendshem ne sektorin publik” dhe Manualit te Auditimit te Brendshem, miratuar me Urdher te Ministrit te Financave nr.100 date 25.10.2016 “Per miratimin e Manualit te Auditimit te Brendshem ne Sektorin Publik”, per vitin 2020 jane planifikuar angazhime auditimi ne 11 subjekte nga të cilat janë realizuar angazhime te Auditimit te Brendshem në 8 subjekte, kater prej të cilave ka përfunduar puna në subjekt dhe po punohet për përpilimin e raporteve të auditimit, ndërsa në kater subjekte të tjera kanë përfunduar procedurat audituese.

I. Permbledhje ekzekutive

Për vitin 2020 jane planifikuar angazhime auditimi ne 11 subjekte nga të cilat janë realizuar angazhime te Auditimit te Brendshem në 8 subjekte, kater prej të cilave ka përfunduar puna në subjekt dhe po punohet për përpilimin e raporteve të auditimit, ndërsa në kater subjekte të tjera kanë përfunduar procedurat audituese.

Me kërkesë të Titullarit gjatë vitit 2020, janë kryer angazhime auditimi tematike në 2 subjekte.

Auditimet janë realizuar me bazë sistemi të kombinuar , të pjesshëm, ku në programet e auditimit janë përfshirë tre sistemet, i perputhshmërisë, performancës dhe ai financiar. Për auditimet e realizuara është zbatuar Manuali i AB, dokumentat e punës si dhe testet sipas fushave të sistemeve.

Për vitin 2020 janë evidentuar gjetje me dëm ekonomik në katër subjekte në shumën **322 mijë leke**.

Për vlerën e dëmit ekonomik është kërkuar zhdëmtimi i tij në masën 100 përqind.

Në auditimin e sistemit të përputhshmërisë u evidentuan shkelje e mangësi në zbatimin e hapave të sistemit IPS, në përpilimin dhe administrimin e dokumentacionit prokurues, në llogaritjen e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, në zbatimin e tarifave të shërbimeve, në administrimin , dokumentimin e dokumentacionit ligjor në arkivë, marrjen dhe dorëzimin me inventar të arkivës, mos kryerje ose kryerje me mangësi e inventarëve të aktiveve, arketime me vonesë të aplikimeve, etj.

Në auditimin e sistemit të performancës konstatohen mangësi në zbatimin e kontrolleve dhe procedurave të vendosura nga menaxhimi për respektimin e afateve të

shërbimeve, ku konstatohet gjëndje e lartë e praktikave të prapambetura dhe një performancë e dobët në zbatimin e afateve, fushë e cila është identifikuar me risk të lartë.

Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna ,në disa raste nuk janë marrë në analize nga menaxhimi i subjekteve të audituara, raportet e AB etj.

Në verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna ne auditimet e kryera një vit më parë , rezulton se, nga 38 rekomandime të lëna , 24 prej tyre ose 63 % ishin zbatuar plotësisht; 5 rekomandime ose 13 % ishin zbatuar pjesërisht dhe 9 rekomandime ose 24% e rekomandimeve të lëna nuk kishin gjetur zbatim.

Për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara gjatë auditimeve për vitin 2020 janë dhënë gjithsej 39 rekomandime nga të cilat 30 rekomandime janë raportuar të zbatuara , ndërsa 9 rekomandime janë në proces zbatimi ku ndjekja e zbatimit të tyre është planifikuar për auditim, për vitin 2021.

II. Baza Ligjore.

Drejtoria e AB në ASHK e ka mbështetur veprimtarinë e saj në Ligjin nr 111 datë 07.02.2019 “ Për Kadastrën” ,, Ligjin Nr.114 datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditimit të Brëndshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brëndshëm në Sektorin Publik”, mbi bazën e të cilave ka realizuar programin vjetor të Auditimit ,miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr.3856 datë 08.10.2019 “ “ Për miratimin e Programit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019” te ndryshuar.

III. Organizimi

Misioni i AB në ASHK është parë nga Drejtoria e AB si një obligim për ti dhënë Menaxhimit siguri objektive, në mënyrë të pavarur, për përmirësimin e veprimtarisë dhe performancës në realizimin e shërbimeve në kohë, me efektivitet dhe të bazuara në ligj dhe konkretisht:

- ✓ Të ndihmojë Institucionin për të permbushur detyrimet ndaj subjekteve fizike dhe juridike në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, rregullave dhe kontrolleve të vendosura.
- ✓ Të japë siguri objektive tek menaxhimi mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe atyre të performancës, të përgatitura nga strukturat e objekteve të audituara.
- ✓ Të ndikojë në rritjen e vlerës nëpërmjet evidentimit të problemeve dhe rekomandimeve të dhëna për rritjen e efektivitetit ekonomik dhe financiar.
- ✓ Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim.

- ✓ Të ndihmojë punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e kontrolleve të vendosura.

Drejtorja e AB në ASHK është e organizuar me 5(pesë) punonjës, një drejtues (Drejtori) dhe 4 (kater) auditë, Specialistë auditë

Në organigramën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr 84 datë 02.05.2019, si dhe në Ligjin Nr 111/2019 "Për Kadastrën", është përcaktuar që Drejtorja e AB varet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe i raporton e miraton tek bordi raportin për veprimtarinë vjetore të AB.

IV. Rezultatet e Veprimtarisë të AB

- Analizë e programeve të AB për periudhën raportuese.

Për vitin 2020 janë planifikuar angazhime auditimi në 11 subjekte nga të cilat janë realizuar angazhime të Auditimit të Brendshëm në 8 subjekte, kater prej të cilave ka përfunduar puna në subjekt dhe po punohet për përpilimin e raporteve të auditimit, ndërsa në kater subjekte të tjera kanë përfunduar procedurat audituese.

Me kërkesë të Titullarit gjatë vitit 2020, janë kryer angazhime auditimi tematike në 2 subjekte.

- Analiza e misioneve të AB.

Realizimi i misioneve të auditimit është mbështetur në programin vjetor 2020, të ndryshuar, si pjesë e programit strategjik 2020-2022.

Para kryerjes së auditimit subjektet janë lajmëruar për misionet e auditimit si dhe për takimin sipas axhendës, takime këto të fiksuara më parë.

Gjate tërë periudhës audituese është bashkpunuar me stafin e subjekteve dhe në përfundim të praktikës audituese në terren është marrë kontakt me menaxhimin e subjektit për të trajtuar problematikat dhe gjetjet nëpërmjet takimit përmbyllës.

Në përgatitjen dhe plotësimin e dosjes audituese janë zbatuar për çdo subjekt hapat e auditimit, nëpërmjet raporteve paraprake, raportet përfundimtare, rishikimit të cilësisë, plan veprimeve dhe memo për Titullarin.

- Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.

Në realizimin e planit vjetor 2020, të ndryshuar, risku është vlerësuar sipas fushave të sistemeve përkatëse e konkretisht:

- Risku nga kryerja aplikimit të shërbimeve sipas tarifave përkatëse dhe vërtetimit të arkëtimeve të tyre nga portali e-albania.

- Risku nga evidentimi dhe administrimi i pagesave online për shërbimet në ASHK.
- Risku nga mangësitë në kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme me punonjësit për procedurat e reja online në aplikimin e shërbimeve dhe arkëtimin e tyre.
- Risku nga kryerja e shërbimeve pa arkëtimin e vlerave të tyre.
- Risku nga mos tarifimi i saktë i shërbimeve të kryera.
- Risku nga llogaritja e pasaktë e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pasurisë së paluajtëshme.
- Risku nga mos kalimit në kohë dhe sipas aplikimeve , të pagesave nga posta shqiptare në llogarinë e Institucionit.
- Risku nga mos evidentimi i saktë i aktiveve.
- Risku i pagesave të anuluar brenda ditës (shërbime,Tatime,Taksa etj), dhe të kaluara sit ë rregullta në sektorët e përpunimit të kërkesave.
- Etj.

Në subjektet e audituara programi i auditimit u përqëndrua në sistemin e përputhshmërisë dhe të performancës si sisteme me risk të lartë .

Ndryshimet e shpeshta në personel përcaktuan dhe koregjime në planifikimin e riskut, për shkak të ndryshimit të tij, ku fusha si llogaritja e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë nga fusha me risk të mesëm e të ulët gjatë një viti më parë, për vitin 2020 kaluan në fusha me risk të lartë, panvarësisht nga gjetjet në kampionet e marrë.

Risku i personelit megjithë masat e marra për uljen e tij nëpërmjet trajnimeve me punonjësit e rinj në drejtim të aftësisë të tyre tekniko profesional si dhe njohjen dhe përshtatjen e procedurave të reja të aplikimeve, tarifimit dhe arkëtimin online , përsëri ky risk paraqitet aktiv në administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor, kryerjen e hapave në system, rakordimin e të ardhurave, llogaritjen e tatimit dhe zbatimin e afateve të shërbimeve.

- Gjetjet kryesore sipas sistemeve.

Për vitin 2020 nga auditimet e kryera në 4 subjekte(katër subjekte të tjera janë në proces, ka mbarruar puna audituese në subjekt) kanë rezultuar gjetje me dëm ekonomik në shumën **322 mijë lekë**, nga të cilat:

- | | |
|---|-----------------------|
| - Tatim mbi kalimin e të drejtës të pronësisë | 156 mijë lekë. |
| - Tarifa shërbime të pa zbatuara | 166 “ “ |

Gjetjet sipas fushave në sistemin e kombinuar rezultojnë si me poshtë:

- Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në tre subjekte.
- Zbatim jo korrekt i tarifave të shërbimeve në tre subjekte.

- Shkelje e mangësi në llogaritjen e tatimit në katër subjekte.
- Mangësi në zbatimin e procedurave prokuruese në tre subjekte
- Nuk janë zbatuar postet e punës sipas strukturës së miratuar në dy subjekte.
- Nuk ka gjetur zbatim detyra e deleguar nga DP për lidhjen e kontratave nga Menaxhimi I DVASHK-së në një subjekt.
- Tejkalime të afateve të shërbimeve në tre subjekte.
- U konstatua në dy subjekte, se marrëdhëniet midis sektorëve nuk janë të unifikuara si DVASHK por në disa raste funksionojnë si sektorë të dy institucioneve të mëparshme ZRPP-ALUIZN
- Në një subject rezultojnë vonesa në evadimin nga menaxhimi të praktikave të përfunduara
- Në tre subjekte rezulton që drejtimi I aktivitetit dhe komunikimi me stafin nuk kryhet çdo muaj dhe I dokumentuar
- Nuk janë kryer ose mangësi tek inventarët e aktiveve në dy subjekt.
- Nuk është bërë markimi me vulë numuratore i referencave , në një subjekt
- Kryerje me mangësi të shërbimit postar në një subjekt.
- Mos kryerja korekte e hapave në sistem, në një subjekte.
- Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet në tre subjekte.
- Në katër subjekte rezulton që të ardhurat kanë pësuar rënie gjatë vitit 2020.
- Në një subject u konstatuan raste të regjistrimit të pasaktë të vlerave të rivlerësuara , në kartelat e pasurive.
- Nuk ka gjetur zbatim në një subject ,detyrimi ligjor për bërjen "nul " në kartelë të vlerës së rivlerësuar pas përdorimit të saj në transaksionin e radhës.
- Në një subject konstatohet se nuk azhurnuar rregullisht nga subjekti I audituar libri pagave konform detyrimit të kërkesave të KP.
- Nuk ka gjetur zbatim në një subject, kërkesa e Kodit të Punës për administrimin e plotësimin e Regjistrimit themeltar të punonjësve.

- U konstatuan parregullsi ne funksionimin e sistemit IT-së në një subject..

V. Rekomandimet.

- Rekomandimet e propozuara.

Në përfundim të cdo mision auditimi janë dhënë për subjektin e audituar rekomandime për të ndihmuar menaxhimin dhe stafin e subjekteve për koregjimin e veprimeve në mënyrë që të shtojnë vlerën e organizatës.

Janë dhënë gjithsej 39 rekomandime, të cilat janë pranuar nga subjektet, dhe 30 prej tyre janë zbatuar , kurse 9 rekomandime janë në proces zbatimi dhe realizimi i plotë i tyre do të jetë objekt auditimi në subjektet gjatë auditimit të rradhës.

Për rekomandimet me dëm ekonomik është kërkuar arkëtimi i dëmit 100 për qind.

Nga rekomandimet e dhëna :

- Në 3 subjekte u la rekomandim që të analizohej nga Menaxhimi e të nxirren përgjegjësitë konkrete për rekomandimet e pranuar por të pa zbatuara , të lëna nga auditimi i meparshëm , pasi risku i moszbatimit të tyre mbetet përgjegjësi e Menaxhimit.
- U la rekomandim në 2 subjektet e audituara që të analizohen rezultatet e testeve të zbatimit afateve të shërbimeve duke përcaktuar kontrolle shtesë për përmirësimin e performancës
- Në 2 subjekte u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-se të nxjerrë urdhrin e brëndshëm dhe të ndjekë zbatimin e tij që nga ana e specialistëve të zbatohen në mënyre korekte hapat e sistemit IPS duke shmangur ndërhyrjet dhe ndërprerjet e ketyre hapave si dhe vonesat në kryerjen e tyre.
- U la rekomandim në tre subjekte që Drejtori i DVASHK-se në cilësinë e kryetarit të Entit Prokurues te nxjerre urdhrin e te ndjeke zbatimin e tij , që në cdo rast të prokurimeve për riparime, nga komisioni i prokurimit të hartohet raporti mbi leverdishmërinë ekonomike të prokurimit në raport me vlerën e mbetur të paisjeve që riparohen.
- Në një subject u la rekomandim që Drejtori të nxjerrë urdhrin e brëndshëm dhe të kërkoj zbatimin e tij, që në zbatim të marrjes së kompetencave nëpërmjet delegimit, për lidhjen e kontratës së punës, në bashkpunim me Drejtorinë përkatëse në ASHK sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr 2453 datë 13.08.2019, Sektori i Financës & Burimeve Njerëzore të lidhë kontratat e punës me punonjësit si dhe të administrojë dokumentacion të noterizuar për diplomimin dhe librezat e punës të punonjësve.

- Në një subject u la rekomandim që Menaxhimi të marrë masat që praktikat e përfunduara dhe të vëna në dispozicion për firmë të evadohen brënda ditës.
- U la rekomandim në një subject që Menaxhimi të marrë masat për vazhdimin e procedurave për vlerësimin, nxjerrjen jashë përdorimit të aktiveve të vlerësuara si të tilla si dhe asgjesimin e evadimit të tyre.
- Në një subject u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-së të nxjerrë urdhërin e brëndshëm dhe të ndjeke zbatimin e tij koregjimin e menjëhershëm të shumës së rivlerësimit, në kartelën e pronësisë nga 13,036,660 lekë në 3,036,660 lekë (apl nr 7335 dt 01,07,2020).
- U la rekomandim në një subject që Drejtori i DVASHK-së të nxjerrë urdhërin e brëndshëm dhe të ndjeke zbatimin e tij për fshirjen e rivlerësimeve për të gjitha rastet kur ato janë përdorur nga individet që kanë bërë rivlerësimin e pasurisë .
- Në një subject u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-së të nxjerri urdhrin e brëndshëm dhe të ndjekë zbatimin e tij, që cdo reference që futet në arkivë të jetë e firmosur dhe vulosur me vulën e kuqe numuratore nga specialistët përgjegjës.
- U la rekomandim në një subject që Drejtori i DVASHK-së të analizojë me stafin problematikën e konstatuar nga auditi lidhur me përfundimin e supozuar nga qytetarët, të shërbimeve të papaguara, dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e IT-së ne Drejtorinë e Përgjithëshme të gjejë zgjidhjet e duhura.
- Në një subject u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-së të nxjerrë urdhrin e të ndjekë zbatimin e tij për azhurnimin rregullisht të librit pagave.
- U la rekomandim në një subject që Drejtori i DVASHK-së të nxjerrë urdhrin e të ndjekë zbatimin e tij për administrimin dhe azhurnimin e regjistrit themeltar sipas formatit të miratuar.
- Në një subject u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-së Shkodër të nxjerrë Urdhrin për ZVASHK-në që kryerja e inventarëve të aktiveve të kryhet për cdo zyrë e të jetë pjesë integrale e unifikimit të aktiveve të DVASHK-së.
- U la rekomandim në një subject që Drejtori i DVASHK-së Shkodër të nxjerrë Urdhrin e të kërkoj zbatimin e tij nga ZVASHK-ja, që pagesat për shpenzimet postare të kryhen kundrejt faturës analitike të paraqitur nga shitësi(Posta shqiptare).
- Në një subject u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-së Korçë të nxjerri urdhrin e brëndshëm për ZVASHK-në Devoll ,dhe të ndjekë zbatimin e tij, që në llogaritjen e RVP-së specialisti të zbatojë kërkesat e Udhëzimit për rivlerësimin e truallit.

- Në një subject u la rekomandim Menaxhimi në kordinim me Drejtoritë përkatëse ne DP të ASHK-së të marrë masat për funksionimin e strukturës dhe organikës sipas vendeve të punës të emëruara nga drejtori I Përgjithshëm.
- U la rekomandim në tre subjekte që Menaxhimi te analizoje me stafin perkeqesimin e treguesve ekonomike dhe te marre masa organizative per rritjen e te ardhurave nepermjet rritjes se performances se sherbimeve.
- Në një subject u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-së të nxjerrë Urdhrin e të kërkoj zbatimin e tij nga ZVASHK-ja për shpërndarjen e praktikave të dorëzuara nga specialisti i liruar nga detyra dhe punimin e tyre.
- U la rekomandim në një subject që Drejtori i DVASHK-së të marrë masat që në bashkpunim me Drejtorinë e IT-së në Drejtorinë e Përgjithëshme të ndjekë e sistemojë parregullsitë ne system.
- Në dy subjekte u la rekomandim që Drejtori i DVASHK-së të nxjerrë urdhrin e të ndjekë zbatimin e tij, që në marrëdhëniet mes sektorëve dhe specialistëve të mënjahohen sa të jetë e mundur burokracitë e shkresave përcjellëse mes tyre në trajtimin e kërkesave për aplikim të qytetarëve.
- U la rekomandim në tre subjekte që Drejtori i DVASHK-së në detyrim të kryerjes së detyrës funksionale të realizojë cdo muaj të dokumentuar takime me stafin, për problematikat e punës, disiplinës dhe ato të njohjes dhe zbatimit të detyrimeve nga urdhërat e shkresat e ardhura nga Drejtoria e Pergjithëshme, të auditimeve e kontrolleve të ASHK-së.
- Për diferencat e konstatuara në zbatimin e tarifave në tre subjekte, në zbatimin e tarifave u rekomandua që të arketohen 100 % në favor të të ardhurave të ASHK-së.
- Për diferencat në llogaritjen dhe arkëtimin e tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë të konstatuara në 3 subjektet e audituara u la rekomandim arkëtimi i tyre 100% në favor të Drejtorisë Rajonale të Tatim Taksave në qytetet përkatëse.
- Etj
- Përgjigja dhe reagimet e menaxhimit.

Rekomandimet e lëna për zbatim janë pranuar nga subjektet duke trajtuar në disa raste dhe observacionet e tyre dhe në konfirmimin e marrjes së Raportit Final te Auditimit kanë raportuar me shkrim realizimin e 30 rekomandimeve ndërsa 9 prej tyre janë në proces zbatimi dhe disa prej rekomandimeve, auditimi i plotë i zbatimit të tyre është programuar në planin e auditimit për cdo subjekt, për vitin 2021 si pjesë e sistemit të kombinuar.

VI. Monitorimi i sistemit dhe sigurimi i cilësisë

Monitorimi dhe sigurimi i cilësisë është realizuar nëpërmjet miratimit të Programit të Sigurimit të Cilësisë, të ndryshuar, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr 3854 datë 08.10.2019.

Monitorimi i Sigurimit të Cilësisë është bërë në të gjithë fazat e auditimit nga P/Grupit të Auditimit dhe Drejtori i AB në ASHK, në përputhje me standartet dhe praktikat profesionale të AB, Manualit të AB si dhe Kartës së Auditimit duke përdorur Cheek listat.

VII. Analiza e kapaciteteve audituese

- Probleme të konstatuara në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë të AB.

Për vitin 2020 funksionimi i Drejtorisë të AB ka qënë me kapacitet të kufizuar, pasi gjatë vitit 2020 Drejtoria e AB u përball me pasojat e pandehmisë të cilat ndikuan dhe në mosrealizimin e proqramit vjetor për vitin 2020.

- Kapacitetet audituese.

Drejtoria e AB në ASHK përbëhet në organikë nga 5 punonjës, 1 Drejtor dhe 4 specialistë

Drejtori dhe një nga specialistët janë diplomuar në shkencat juridike, ndërsa dy specialistët e tjerë janë diplomuar në shkencat ekonomike.

Drejtori i AB ka një eksperiencë në AB 9 vjecare, dhe inspektorët kanë eksperiencë 3,9 dhe 16 vite. inspektorë kanë një eksperiencë në audit 2 dhe 16 vite.

Gjithe stafi i Drejtorisë të Auditimit është i certifikuar si “Audit i brendshëm në sektorin publik”

- Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve.

Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve është realizuar në trajimet e realizuara nga DH për AB në MF.

Për vitin 2020 janë trajnuar online nga DH në MF, Drejtori dhe 4 specialistët e auditimit.

VIII. Konkluzione

- Konkluzione mbi problematikën e punës audituese.

Programi vjetor i Auditimit të Brëndshëm për vitin 2020 u ndryshua duke zvogeluar numrin e subjekteve për tu audituar për shkak të periudhës së pamdehmisë.

Megjithë ndryshimin e programit , përsëri programi nuk u realizua për shkak të rëndimit të situatës nga pandehmia dhe infektimit të personelit të AB.

Për rekomandimet e pazbatuara është informuar Menaxhimi i Institucionit për ta konsideruar si risk që marrin subjektet në veprimtarinë e tyre.

Bashkepunimi me Drejtoritë Operative në ASHK dhe vecanërisht me Drejtorinë e IT-së ka cuar në përgatitjen me të mirë të punës paraprake audituese si dhe në nxjerrjen e konkluzioneve të sakta për gjetjet e auditimit, duke u rekomanduar Drejtorive përkatëse nxjerrjen e shkresave për unifikimin, interpretimin e rasteve të vecanta etj, si dhe në dhënien e rekomandimeve menaxhimit për përmirësimin e drejtimit dhe vendosjen e kontrolleve dhe procedurave më të plota në aktivitetin e subjekteve.

Trajtimi me kujdes i observacioneve të bëra nga subjektet për materialin auditues ka cuar në përmirësimin e punës audituese.

- Prioritetet për vitin 2021

Për vitin 2021 prioritet do të jetë zbatimi i programit të auditimeve duke siguruar realizimin e planit vjetor.

Auditimi mbi bazë risku jo vetëm si subjekte por dhe për problematika të vecanta, do të jetë një tjetër prioritet i zbatimit të programeve audituese për vitin 2021, ku risku I menaxhimit të të ardhurave do jetë prioritet kryesor.

Vëmëndje gjatë vitit 2021 do ti kushtohet dhe ndjekjes së trajnimeve të planifikuara nga Drejtoria e Harmonizimit për AB, Kryeministria si dhe Institucioni, ASHK-ja.

Në kushtet e shtrirjes së sistemit elektronik të aplikimeve në të gjitha subjektet e ASHK-së, aplikimi online nga kërkuesit , trajnimi dhe konfidenca me sistemin IPS dhe MF do të jetë objektivi i vazhdueshëm i Drejtorisë AB, në mënyrë që rezultatet e punës audituese të implementimit të këtyre sistemeve të ndihmojnë subjektet dhe menaxhimin për marrjen e veprimeve koregjuese.

Bashkëpunimi me Drejtoritë Operative në ASHK do të jetë një nga synimet e Drejtorisë të AB në mënyrë që jo vetëm të harmonizohen programet audituese dhe te mos ketë mbivendosje, por dhe të adresohen saktë gjetjet dhe masat që keto të mos përsëriten.

DREJTORI I AUDITIMIT TË BRËNDSHËM

Erjon ZOTO

Tirane me 25.01.2021